1/2"	15	56	28	52	16	77	25	13,3
3/4"	20	62	31	69	21	95	31	25,8
1"	25	76	38	77	25	95	39	50,9
1 1/4"	32	86	43	87	30	95	47	103
1 1/2"	40	97	48	108	37	137	54	147
2"	50	111	55	124	46	137	67	222
2 1/2"	65	153	76	169	58	187	82	336
3"	80	173	87	188	68	187	96	377
4"	100	217	108	241	88	257	126	645

IMPIANTI I MBROJTJES NGA ZJARRI “MKZ”

1. Pershkrimi i impiantit, normat e projektimit, dhe kalkulimet.

1.1 Hyrje

Hartimi i projektit te impianti te mbrojtjes nga zjarri MKZ eshte mbeshtetur ne dispozitat legjislativ shqiptare, vendimi Nr.699 date 22.10.2004, si dhe mbi normat europiane te cilat vijne ne mbeshtetje te ketij vendimi. Ky projekt ka per qellim mbrojtjen e jeteve njerezore dhe te mirave materiale nga rrezja e zjarrit. Nepermjet ketij projekti sigurojme dy forma te mbrojtjes nga zjarri per situatat emergjente, si dhe per shuarjen e zjarrit.

a. Mbrojtjen aktive

Kjo forme mbrojtje ka te beje me instalimet e impianteve mekanike dhe automatike te shuarjes se zjarrit.

Impiantet mekanike te shuarjes se zjarrit perbehen nga pajisjet te tilla si:

- hidrantet e brendshem
- hidrantet e jashtem
- bombulat me shkume
- bombulat me pluhur
- bomulat me gaze halogjenike.

Ndersa impiantet automatike te shuarjes se zjarrit perbehen:

- impianti me sprinklera, me aktivizim automatik,
- impiantet automatike me bombula stacionare me gazra halogjenik, ku shperndarja e gazit ne zonat e mbrojtura behet nepermjet tubacioneve.

b. Mbrojtja pasive

Mbrojtja pasive ka te beje me materialet perberese te strukturave te ndertesave te cilat vleresohen mbi bazen e vetive zjarrduruese, te cilat percaktohen nga rezistenca qe i paraqesin zjarrit ne kohe, dhe klasat e materialeve te djegshme:

R- Rezistenca e pjeseve te jashtme te objektit ndaj zjarrit shprehur ne minuta (0-120)

REI- rzesstenca e pjeseve te brendshme te objektit shprehur ne minuta (0-120)

RE- rezistenca e e dyerve te dhomave kjo e fundit e shprehur ne minuta.

Lartesia antizjarr- lartesia e objekteve e shprehur ne metra, me ndarje te tilla si 0-24meter 24-54, meter, mbi 54 meter.

KLASA 0- Materiale te padjegshme

KLASA 1- Materiale qe digjen me veshtiresi







KLASA 2- Materiale te djegshme

KLASA 1 IM- Materiale perberese te mobilieve.

Si dhe ndarjen e ndertesese ne komparticione zonale, ndertimin, ndertimin e filtrave, si dhe rruget e shpetimit dhe daljet emergjente. Gjate periudhes se aplikimit te sistemit eshte mire qe kontraktori te kontaktohet me autoritetet vendore te MKZSH per te siguruar nje testim dhe aprovim te instalimit te ketij impianti.

1.2 Ndarja e zonave dhe klasifikimi i zjarreve.

Per te perdorur agjentet shuares gjate momenti kur bie zjarr, me pare duhet te behet nje analize e materialeve te djegshem qe ndodhet ne ate zone, dhe mbi bazen e kesaj analize behet dhe klasifikimi i zjarreve dhe me pas zgjidhet agjenti dhe pajisja shuares qe do perdoret ne ate zone. Nga sa permendem me siper, si dhe duke u mbeshtetur mbi normat dhe standartet bashkekohore, zjarret i ndajme ne 6 klasa te cilat shprehen ne tabelen e meposhtme:

TABELA E KALSIFIKIMIT TE ZJARREVE			
1		Klasa A	Zjarret qe kane burimin nga objekte te ngurta sic jane, druret, letra, plastike dhe tekstile
2		Klasa B	Zjarret qe kane burimin nga materialeve telengshem, sikurse benzene , benzole , nafte, alkol , vajra etj.
3		Klasa C	Zjarret qe e kane burimin nga materialeve te gazte sikurse metan , propan , butan GPL etj.
4		Klasa D	Zjarret qe e kane burimin nga prej materialeve metalike sikurse alumin, magnesium, sodium, etj.
5		Klasa E	Zjarret qe e kane burimin nga pajisjete nen tension.
6		Klasa F	Zjarret qe e kane burimin nga gatimi i ushqimeve ne guzhina

1.3 Pajisjet dhe agjentet shuares

Ne baze te karakteristikave dhe te natyres se ambienteve, si dhe aktiviteteve qe kryhen ne kete godine, atehere ne do te perdorim keto pajisje dhe agjente shuares respektivisht ambientit:

1.1.1 Agjentet shuares.

- a- Ne ambjentin teknik do te perdorimi bombula me gaz halogjenik. Ose pluhur hidrokarburesh.
- b- Ne ambjentet restorantit do te perdorim, bombula me shkume.
- c- Ne holl do te perdorim hidrante me uje.



Karrelato



Bombula Murale



Hidrant kasete

1.4 Kriteret e pergjithshme projektuese

Siç e kemi përmendur dhe në piken 1.1, hartimi i projekti është bërë mbi bazën e kërkesave dhe normave të pajisjeve dhe agjenteve shuarez që do të aplikohen konkretisht. Duke konsideruar që impianti me hidrante uji të pjesën më të madhe të sistemit të mbrojtjes nga zjarri, atëherë këtij lloji sistemi i bëhet një analizë e tillë, duke të zgjedhur dhe si tipologji të sistemit.

Sistemi i mbrojtjes nga zjari me hidrant, varet kryesisht nga kapacitetet e ujit të rezervuarit, si dhe nga presioni i rrjetit të këtij impianti, të cilët minimalisht duhet të respektojnë normat përkatëse të dhëna në Vendimin 699 datë 22.10.2004, si dhe normat europiane. Nuk duhet anashkaluar që ky sistem duhet të jetë lehtësisht i përdorshëm, duke krijuar mundësi të kontrollit, mirëmbajtjes dhe të shuarjes në kohën e duhur në rast rënies së zjarrit.

1.1.2 Faktoret përcaktues gjatë projektimit

Gjatë fazës së projektimit janë marrë në konsideratë pikat e mëposhtme:

- Natyra e mundshme e zjarrit, përmasa e mundshme e zjarrit;
- Pozicioni dhe madhësia e zonës së cilës konsiderohet të mbrojtur;
- Shpejtësia e mundshme e përhapjes së zjarrit;
- Kërkesat dhe normat shqiptare si dhe normave UNI 10779 si dhe ato që janë në fuqi në Shqipëri.

1.1.3 Furnizimi me ujë të impiantit të mbrojtjes nga zjarri

Është i domosdoshëm furnizimi me sasinë e nevojshme të ujit të cili do të shfrytëzohet nga impianti nëpërmjet hidranteve në rastin më të parë që do të shfaqet zjarri në mënyrë që të evitohet menjëherë përhapja e metejshme e tij. Kjo sasi uji i korrespondon sasisë së përcaktuar të cilës përlogaritë referuar sasisë së ujit të një hidranti si dhe njekohëshmerisë së përdorimit të hidranteve të impiantit në teresi. Këto llogaritje janë dhe në piken 1.4.3 dhe bëhen në bazë të normave dhe standardeve shqiptare në fuqi. Një rëndësi të veçantë ka dhe sasia e nevojshme e ujit, e cila bëhet e mundur nëpërmjet një grupi rezervuarësh cilindrik, të cilët ndodhen brenda ambientit teknik për të cilët flitet më gjerësisht në piken 1.5.

1.1.4 Sasia dhe presioni i nevojshem i ujit per te furnizuar impiantin.

Sasia e nevojshme e ujit llogaritet mbi bazen e numrit te hidranteve te cilet mund te perdoren ne te njejten kohe ne rast renie zjarri. Veç kesaj qe permendem, duhet garantuar qe edhe hidranti i cili eshte ne pozicionin me te disfavorshem perkundrejt impiantit, te furnizohet me sasine dhe presionin e caktuar nga standarti. Duke ju referuar metodikes se lartpermendur arrijme qe te perlllogarisim dhe sasine totale te nevojshme te ujit i cili do te perdoret ne rast se bie zjarri, i cili do te jete i mjaftueshem per procesin e shuarjes se zjarrit.

Konkretisht jane konsideruar aktivite qe kryhen ne godine, si dhe lendet dhe materialet te cilat jane depozituar brenda. Duke ju referuar normave impianti i cili do te perdoret do te kete keto karakteristika:

- Duhet garantuar nje sasi uji qe do te frunizoje **1 Hidrante Kasete**.
- Nje hidrant duhet te kete nje prurje prej **$V = 35 \text{ lit/min}$** .
- Hidranti me i disfavorshem duhet te kete nje presion prej min/max **$P = 2\div 4.5 \text{ bar}$** .
- Kohezgjatja e furnizimit me uje duhet jo me pak se **60 min**

Referuar percaktimeve te mesiperme, perfundimish do te kemi nje sasi uji prej:

$$V = 1 * 35 * 60 = 2100 \text{ lit/h}$$

Perfundimisht sasia e nevojshme e ujit do te jete: $V = 2.1 \text{ m}^3$

Rezervuari i ujit.

Rezervuaret e ujit do te jene prej llamarine te xinguar dhe do te vendosen brenda ambientit teknik afer stacionit te pompave. Forma e rezervuareve do te jet cilindrike dhe do te vendosen vertikalisht. Rezervuari i ujit do te bej te mundur montimin:

- Tubacionet e furnizimit me uje.
- Tubacioni i thithjes se pompes.
- Tubo shkarkimi ne rastin e tejmbushjes.
- Pompa e shkarkimit ne rastin e pastrimit apo nderrimit te ujit.
- Galexhantin mekanik per te mos lejuar tejmbushjen.



Keto rezervuare sigurojne sasine e mjaftueshme te ujit qe i nevojitet impiantit te mbrojtjes nga zjarri. Duke siguruar nje kohezgjatje e cila i pergjigjet normave ne fuqi.

Shenim:

Eshte e detyrueshme qe rezervuaret te lidhen ne lartesi te tilla siç eshte treguar ne skemen principale, si dhe te boshatisen nje here ne tre muaj, dhe te dizinfektohen me klor. Kjo per arsye shmagjien e ndotjes se ujit dhe mundesine e krijimit te algave.

VLERESIMI STATIK DHE SIZMIK PER OBJEKTIN

HYRJE

Ne kete raport eshte paraqitur vleresimi statik dhe sizmik i objektit ekzistues me emertim:


RIKONSTRUKSION I SHKOLLES SE MESME TE PERGJITHSHME "HAXHI LATA" SUÇ, BASHKIA KLOS.

Ndertesa eshte perkatesisht 3 kate mbi toke pa podrum me siperfaqe rreth 605 m² / kat, me forme te rregullt ne plan dhe me forme te rregullt ne vertikaltet. Objekti ka konstruksion mbajtes me murature.

Themelet jane realizuar me rripa te kryqezuar prej guri dhe buto beton nen muraturen mbajttese. Muret mbajtes krijojne ndarje te rregullta me hapsira 5-6 m. Muratura mbajttese eshte realizuar me tulla me gjeresi 38 cm ne te treja katet.

Muratura ndarese eshte realizuar pjeserisht me tulla te plote dhe pjeserisht me tulla me vrime me gjeresi 25, 12 dhe 8 cm.

Soletat jane realizuar me panele b/a me trashesi 15 cm.



Plani i Themeleve Ekzistues te objektit.

Qellimi i hartimit te ketij raporti eshte:

1. Te verifikohet qendrueshmeria statike dhe sizmike per objektin ekzistues, ne menyre qe te hartohet projekti i rforcimit strukturor.

1. KONSTRUKSIONI I OBJEKTIT EKZISTUES

Menyra e projektimit dhe ndertimit te objektit me emertim "RIKONSTRUKSION I SHKOLLES SE MESME TE PERGJITHSHME "HAXHI LATA" SUÇ, BASHKIA KLOS", eshte verifikuar mbi bazen e projektit ekzistues.



Nga shqyrtimi i projektit ekzistues mund te permendim disa vecori ndertimore te objektit te konsideruar, si me poshte:


1. Ndertesa qe do te verifikohet eshte me 3 kate dhe eshte ndertuar ne nje zone me intensitet VIII balle sipas shkalles MSK-1964. Lartesia totale e objektit eshte 9.80 m ndersa lartesite e kateve jane: $H_{1-5} = 2.80$ m. Dimensionet ne plan te ndertesese jane: gjatesia e objektit $L_x = 42.40$ m dhe $L_y = 23.46$ m.
2. Themelet e ketij objektit jane projektuar dhe ndertuar si themele te vazhduara nenmurature. Muratura e themeleve eshte projektuar dhe zbatuar me gure kave M-200 dhe llac bastard me M-30. Mbi shkallezimet e themeleve jane vendosur breza betoni me trashesi 10cm te cilat jane realizuar me beton M-150. Gjithashtu, ne kuoten e dyshemese se katit perdhe jane vendosur breza betoni te armuar me trashesi 10cm. Ato jane realizuar me beton M-150 dhe hekur Ç-3 me rezistence $R_{ak} = 2400$ kg/cm² per armaturen gjatesore dhe hekur Ç-3 me rezistence $R_{ak} = 2100$ kg/cm² per armaturen terthore. Sipas shenimit ne projekt, themelet mbeshteten ne shtresen e dyte. Kjo shtrese toke ka nje aftesi mbajttese te lejuar, e cila ne projekt eshte raportuar, $[\sigma] = 2.5$ kg/cm².
3. Sistemi konstruktiv eshte realizuar me murature. Muret mbajttese jane realizuar me murature me tulle te plote me marke M-75. Ato kane trashesine 38cm ne te gjitha katet. Llaci i muratures eshte i markes M25. Me kete murature eshte realizuar konstruksioni mbajtes i cili sherben per transferimin e ngarkesave te nderkateve ne bazament dhe perballimin e forcave horizontale sizmike, dhe ai ndares i cili sherben per ndarjen e ambienteve te brendshme.
4. Soletat jane realizuar me panele betonarme lartesi 15cm.
5. Shkallet e objektit jane realizuar me beton te armuar te derdhur ne vend. Ne fletet e projektit qe na jane vene ne dispozicion nuk pasqyrohet armimi i tyre, por nisur nga elementet e tjere konstruktive, mendojme qe shkallet jane realizuar me beton M-200 dhe hekur Ç-5 me rezistence $R_{ak} = 2400$ kg/cm² si per armaturen ne drejtimin gjatesor ashtu dhe per ate ne drejtimin terthor.

2.1 VLERESIMI STATIK OBJEKTIN NE GJENDJEN EKZISTUESE

Ne kete pjese te raportit paraqiten rezultate e verifikimit te objektit ne gjendjen ekzistuese nen veprimin e ngarkesave statike. Theksojme se gjate verifikimit eshte bere llogaritja e te gjitha seksioneve te muratures se ndertesese, por me poshte jane treguar rezultatet e llogaritjeve per seksionet te cilat kane rezultuar me me teper probleme. Kontrolli i sforcimeve ne taban eshte bere per themelin perkates te cdo rasti. Gjithashtu, ne fund jepet edhe vleresimi per elementet e tjere konstruktive te objektit, soletat e cdo nderkati, shkallet si dhe brezat e vendosur per te mbajtur mure ne drejtimin e hedhjes se soletave. Vleresimi i tyre behet mbi bazen e kerkesave te kushtit sizmik (KTP-N.2-89), si dhe mbi bazen e ngarkesave te shfrytezimit qe perputhen me destinacionin e perdorimit te objektit.

Planimetrite e kateve te objektit ekzistues.





2.1.1 Vleresimi Statik

Me poshte jepen rezultatet e llogaritjeve qe jane bere per 2 seksione te ndertesese te cilet kane rezultuar si me problematiket dhe me demtimet me te medha gjate verifikimeve te kryera. Seksioni i pare eshte ai sipas aksit F dhe seksioni i dyte eshte ai sipas aksit B. Ngarkesat e perdorura per verifikimin e objektit ashtu sic ndodhet ne gjendjen aktuale jane treguar me poshte dhe ne menyre te permbledhur jane paraqitur ne Tabelen 1.

- ngarkesa e soletes $g = 485 \text{ daN/m}^2$
- ngarkesa e perkohshme $p = 280 \text{ daN/m}^2$
- ngarkesa e muratures e shperndare $p_o = 150 \text{ daN/m}^2$
- ngarkesa e murit 12cm $g_{mur12} = 345 \text{ daN/m}^2/\text{ml}$
- ngarkesa e murit 25cm $g_{mur25} = 614 \text{ daN/m}^2/\text{ml}$
- ngarkesa e murit 38cm $g_{mur38} = 883 \text{ daN/m}^2/\text{ml}$

Tabela 1. Ngarkesat llogaritese te perdorura per verifikim

g (daN/m ²)	p (daN/m ²)	p_o (daN/m ²)	$g_{mur 12}$ (daN/m ²)	g_{mur25} (daN/m ²)	g_{mur38} (daN/m ²)
485	280	150	345	614	883

Llogaritja ne shtypje jashteqendrore e murit te godines sipas aksit F.

Per te verifikuar seksionet e ndryshme te mureve mbajtes kemi llogaritur forcat e brendshme qe vijne ne secilin prej ketyre seksioneve dhe ato i kemi krahasuar me aftesine mbajttese te murit ne seksionin perkates. Forcat e brendshme ne seksione te caktuara te mureve percaktohen ne funksion te peshes vetiake te mureve si dhe reaksioneve qe shkarkojne nga soleta ne murature. Ato percaktohen me ane te formulave te meposhtme:

$$N_p = g_{m12} * l_c * h_p, \text{ pesha vetiake e mureve.}$$

$$R_{si} = R_g + R_p, \text{ reaksioni total qe shkarkohet nga soleta ne murature.}$$

$R_g = (g + p_o) * l_c * \frac{l_s}{2}$, pjesa e reaksionit te soletes qe shkaktohet nga pesha e perhershme e saj.

$R_p = p * l_c * \frac{l_s}{2} * \eta$, pjesa e reaksionit te soletes qe shkaktohet nga ngarkesa e shfrytezimit.

Ku:

h_p – lartesia e parapetit.

l_c – hapesira llogaritese midis dy hapjeve.

l_s – hapesira llogaritese e soletes.

η – eshte koeficienti i ngarkeses se perkohshme, $\eta = 0.3 + \frac{0.6}{\sqrt{n}}$.

n – eshte numri i kateve mbi seksionin te cilin konsiderojme ne llogaritje.

Sipas KTP-9-1978, aftesia mbajtese e lejuar e mureve per rastin me jashqendersi te vogel llogaritet me formulen e meposhtme:

$$[N] = \frac{m * m_k * \varphi * R * F}{1 + \frac{e_0}{h - y}}$$

Ku:

$e_0 = \frac{M}{N}$ – eshte jashqendersia e forces N nga qendra e gravitetit e prerjes terthore te

murit. Ajo duhet te plotesoje nderkohe kushtin $e_0 \leq 0.45 * y$

y – eshte largesia nga qendra e gravitetit deri ne anen (faqen) me te nderur te seksionit te murit.

m – eshte koeficienti i pergjithshem i kushteve te punes.

m_k – eshte koeficienti i kushteve te punes se muratures.

φ – eshte koeficienti i perkuljes gjatesore.

R – eshte rezistenca e llogaritjes ne shtypje.

F – eshte siperfaqja e prerjes terthore te murit.


h – eshte lartesia e prerjes terthore te murit.

N – eshte ngarkesa normale llogaritese qe shkarkon ne murature.


M – eshte momenti llogarites qe shkarkon ne murature.

Ne tabelat e meposhtme jane dhene ne menyre te permblodhur vlerat e madhesive te permenduara me siper dhe qe na duhen ne procesin e llogaritjes se seksioneve te caktuara te muratures.

DETAJ I PERFORCIMIT TE MURIT CH I:50



DETAJ I PERFORCIMIT TE MURIT CH I:50



Prerjet terthore te seksionit te konsideruar per objektin ekzistues

Tabela 2. Vlerat e madhesive te perdorura ne llogaritjen e mureve.

h1(m)	h2(m)	h3(m)	Kati	$\eta = 0.3 + \frac{0.6}{\sqrt{n}}$	\sqrt{n}	Numri i kateve
0.7	1.15	0.95	III	0.646	1.73	3
0.7	1.15	0.95	II	0.600	2.00	4
0.7	1.15	0.95	I	0.568	2.24	5

Tabela 3. Distancat e konsideruara ne llogaritjen e mureve.

Hapesira llogaritese e soletes ls(m)	Hapesira midis dy hapjeve lc(m)	Seksioni i murit i konsideruar lmur(m)
4.7	3.07	1.97

Me poshte referohen rezultatet e llogaritjeve per seksionin e konsideruar te murit. N dhe M jane forcat e brendshme te shkaktuara ne secilin prej seksioneve te permendura te murit nga ngarkesat e jashtme te llogaritjes ndersa [N] eshte aftesia mbajtese e lejuar e seksionit te konsideruar.

Disa prej madhesive te perdorura ne llogaritjet e meposhtme si dhe seksionet ku llogariten forcat e brendshme, specifikohen ne figuren me sipër qe tregon prerjen terthore te murit.

N, M

$$[N] = \frac{m * m_k * \varphi * R * F}{1 + \frac{e_0}{h - y}}$$

$N_{1-1} = N_p + R_{s5} =$	6928.83daN	$[N] =$	50353daN
$M_{1-1} = -N_p(t_{m25} - t_p)/2 + R_{s3} * t_{m25}/6 =$	337.73daNm		
$N_{2-2} = N_{1-1} + g_m * h_1 * l_c =$	8248.32daN	$[N] =$	55345daN
$M_{2-2} = M_{1-1} * D_1/H =$	272.78daNm		
$N_{3-3} = N_{2-2} + g_m * h_2 * l_m =$	9639.34daN	$[N] =$	41479 daN
$M_{3-3} = M_{2-2} * D_2/H =$	99.67daNm		
$N_{4-4} = N_{3-3} + g_m * h_3 * l_c =$	11430.07daN	$[N] =$	69988 daN
$M_{4-4} = M_{3-3} * 0/H =$	0 daNm		
$N_{5-5} = N_{4-4} + R_{s4} =$	17474.33daN	$[N] =$	60814 daN
$M_{5-5} = R_{s2} * t_{m25}/6 =$	334.68 daNm		
$N_{6-6} = N_{5-5} + g_m * h_1 * l_c =$	18793.82daN	$[N] =$	62950 daN
$M_{6-6} = M_{5-5} * D_1/H =$	278.39daNm		
$N_{7-7} = N_{6-6} + g_m * h_2 * l_m =$	20184.84daN	$[N] =$	43431 daN
$M_{7-7} = M_{6-6} * D_2/H =$	101.72daNm		
$N_{8-8} = N_{7-7} + g_m * h_3 * l_c =$	21975.57daN	$[N] =$	70410 daN
$M_{8-8} = M_{7-7} * 0/H =$	0 daNm		
$N_{9-9} = N_{8-8} + R_{s3} =$	27862.56daN	$[N] =$	102968 daN
$M_{9-9} = -N_{8-8}(t_{m38} - t_{m25})/2 + R_{s1} * t_m$	505.41 daNm		
$N_{10-10} = N_{9-9} + g_m * h_1 * l_c =$	29760.13daN	$[N] =$	105203 daN
$M_{10-10} = M_{9-9} * D_1/H =$	408.22daNm		
$N_{11-11} = N_{10-10} + g_m * h_2 * l_m =$	31760.57daN	$[N] =$	70636 daN
$M_{11-11} = M_{10-10} * D_2/H =$	149.16daNm		
$N_{12-12} = N_{11-11} + g_m * h_3 * l_c =$	34335.84daN	$[N] =$	112798 daN
$M_{12-12} = M_{11-11} * 0/H =$	0 daNm		

Duket qarte se ne te gjitha seksionet e konsideruara ne lartesi te murit aftesia mbajttese eshte me e madhe se forca e brendshme ($[N] > N$) qe lind nga veprimi i forcave te jashtme vepruese. Mund te themi se seksioni është i siguruar në shtypje jashtëqendrore, pra muri eshte permasuar ne rregull.

Llogaritja e sforcimeve ne taban per themelin e murit te godines sipas aksit F.

Kontrolli i sforcimeve ne tabanin e themelit, ku shkarkon muri i konsideruar sipas aksit F, behet per ngarkesat qe shkarkojne ne kuoten e siperme te themelit, pra per ngarkesat e seksionit te fundit (20-20) te permendur ne llogaritjet e mesiperme. Sforcimet qe rezultojne ne taban nga veprimi i kesaj ngarkese krahasohet me vleren e sforcimeve te lejuara te bazamentit qe jepet ne projektin ekzistues, $[\sigma] = 2.5$

kg/cm². Peshra volumore e tokes e permendur ne Raportin e Vleresimit eshte $\gamma = 1.94$ gr/cm³.

$N_{12-12} = 34335.84$ daN

Pesha vetiake e themelit, sipas permasave te referuara ne projektin ekzistues eshte:

$$N_{th} = \{(2*1)\} + (0.2*1)\} * g_{th} * l_c = 17560 \text{ daN}$$

Ngarkesa totale qe vjen ne tabanin e themelit:

$$N_t = N_{12-12} + N_{th} = 34335.84 + 17560 = 51.90 \text{ kN}$$

Sipas projektit ekzistues, gjeresia e themelit ne kete seksion te konsideruar eshte, $b_{th} = 1.0$ m. Sforcimet ne taban do te jene:

$$\sigma = \frac{N_T + l_c * h_{th} * \gamma}{l_c * b} =$$

$$\sigma = 2.88 \text{ daN/cm}^2$$

Duket qarte se ne seksionin e konsideruar aftesia mbajttese e lejuar e tokes eshte me e vogel se sforcimi i shkaktuar ne taban ($[\sigma] < \sigma$) nga veprimi i forcave te jashtme qe shkarkojne ne kuoten e siperme te themelit. Mund te themi se themeli ne kete pjese te nderteses nuk është i garantuar, pra themeli eshte i nendimensionuar.

Llogaritja ne shtypje jashtegendrore e murit

Ne Tabelen 4 jane dhene vlerat e disa prej madhesive qe na duhen ne procesin e llogaritjes se seksioneve te caktuara te muratures. Te dhenat e tjera merren sipas Tabelave 1 dhe 2 te trguara me siper.

Figura 6. Prerjet terthore sipas aksit B te seksionit te konsideruar per objektin ekzistues

Tabela 4. Distancat e konsideruara ne llogaritjen e mureve.

Hapesira llogaritese e soletes l_{s1} (m)	Hapesira llogaritese e soletes l_{s2} (m)	Seksioni i murit i konsideruar l_{mur} (m)
3.85	4.40	1.0

Me poshte jepen rezultatet e llogaritjeve ne seksionet e konsideruara te murit sipas aksit B. Disa nga madhesite e perdorura ne llogaritjet e meposhtme si dhe seksionet ku llogariten forcat e brendshme, specifikohen ne Figuren 4 qe tregon prerjen terthore te murit sipas seksionit B.

N, M

$$[N] = \frac{m * m_k * \varphi * R * F}{1 + \frac{e_0}{h - y}}$$

$N_{1-1} = R_{s5} =$	3658.87 daN	$[N] =$	64180 daN
$M_{1-1} = R_{s5} * t_{m25}/6 =$	212.78 daNm		
$N_{2-2} = N_{1-1} + g_m * h * l_m =$	5255.27 daN	$[N] =$	94039 daN
$M_{2-2} = M_{1-1} * 0/H =$	0 daNm		
$N_{3-3} = N_{2-2} + R_{s4} =$	8711.17 daN	$[N] =$	80108 daN
$M_{3-3} = R_{s4} * t_{m25}/6 =$	197.07 daNm		
$N_{4-4} = N_{3-3} + g_m * h * l_m =$	10307.57 daN	$[N] =$	94606 daN
$M_{4-4} = M_{3-3} * 0/H =$	0 daNm		
$N_{5-5} = N_{4-4} + R_{s3} =$	13673.55 daN	$[N] =$	129642 daN
$M_{5-5} = R_{s3} * t_{m38}/6 =$	288.98 daNm		
$N_{6-6} = N_{5-5} + g_m * h * l_m =$	15969.35 daN	$[N] =$	151561 daN
$M_{6-6} = M_{5-5} * 0/H =$	0 daNm		

Duket qarte se ne te gjitha seksionet e konsideruara ne lartesi te murit aftesia mbajtese eshte me e madhe se forca e brendshme ($[N] > N$), pra mund te themi se seksioni është i siguruar në shtypje jashtëqendrore. Muri eshte permasuar ne rregull.

Llogaritja e sforcimeve ne taban per themelin e murit te godines sipas aksit B.

Me poshte eshte paraqitur kontrolli i sforcimeve ne tabanin e themelit sipas aksit B. Ngarkesat e konsideruara ne llogaritje jane ato te seksionit te fundit (10-10).

$$N_{6-6} = 15969.35 \text{ daN}$$

$$N_{th} = \{(2 * 1.2)\} + \{0.2 * 1.2\} * g_{th} * l_c = 5148 \text{ daN}$$

Ngarkesa totale qe vjen ne tabanin e themelit:

$$N_t = N_{6-6} + N_{th} = 15969.35 + 5148 = 21.12 \text{ kN}$$

Gjeresia e themelit ne kete seksion eshte, $b_{th} = 1.2$ dhe sforcimet ne taban do te jene:

$$\sigma = \frac{N_t + l_c * h_{th} * \gamma}{l_c * b} =$$

$$\sigma = 3.10 \text{ daN/cm}^2$$

Duket qarte se ne seksionin e konsideruar aftesia mbajtese e lejuar e tokes eshte me e vogel se sforcimi i shaktuar ne taban ($[\sigma] < \sigma$) nga veprimi i forcave te jashtme qe shkarkojne ne kuoten e sipërme te themelit. Mund te themi se themeli ne kete pjese te ndertesës nuk është i garantuar, pra themeli eshte i nendimensionuar.

2.2 Vleresimi Sizmik per objektin ne gjendjen ekzistuese

Ne kete pjese te raportit paraqiten rezultate e verifikimit te objektit ne gjendjen ekzistuese nen veprimin e ngarkesave sizmike. Theksojme ketu se ky verifikim mbeshtetet ne kerkesat e kushtit te ri sizmik KTP-N.2-89, i cili ka hyre ne fuqi mbas vitit 1989, nderkohe qe objekti qe vleresohet eshte projektuar ne vitin 1988. Gjate verifikimit eshte bere llogaritja e te gjitha seksioneve te muratures se ndertesës, por me poshte eshte treguar llogaritja vetem per seksionin me kritik te saj.

2.2.1 Vleresimi Sizmik

Me poshte jepen rezultatet e llogaritjeve vetem per seksionin me kritik te ndertesës, i cili nga verifikimet e kryera rezulton te jete seksioni ne Zonen 4 sipas aksit F.

Verifikimi nga ngarkesat sizmike i murit te godines sipas aksit F.

Vleresimi i forcave sizmike ne nivelin e cdo kati te objektit eshte bere mbi bazen e KPT-N.2-1989 per sizmicitet VIII balle sipas shkalles MSK-1964. Sipas ketij kushti, per objektet me murature shperndarja ne lartesi i korespondon formes se pare te lekundjeve vetjake dhe ka forme lineare. Forca sizmike vepruese ne kat, per formen e pare te lekundjeve, llogaritet me formulen:

$$E_k = k_E * k_r * \psi * \beta * \eta_k * Q_k$$

Ku :

k_E – forca sizmike ne katin (k) te godines. Per rastin e objektit tone, forcat e llogaritura sizmike jane paraqitur ne Tabelen 5.

k_E – koeficienti i sizmicitetit te zones ($k_E = 0.26$, per intesitet VIII balle dhe kategori te trete trualli).

k_r – koeficienti i rendesise se objektit ($k_r = 1.3$).

β - koeficienti dinamik ($\beta = 2$, per troje te kategorise se trete).

ψ - koeficienti i struktures ($\psi = 0.38$, per ndertesë me mure mbajtese te perforcuara me kollona prej betoni te armuar).

η_k - koeficienti i shperndarjes se ngarkesës sizmike ne nivelin (k), qe llogaritet me

formulen:

$$\eta_k = \frac{3k}{2n + 1}$$

k – niveli (kati) perkates.

n – numri i kateve te ndertesës.

Q_k - pesha e pjeses se godines qe perqendrohet ne nivelin (k). Per rastin e objektit tone peshat e llogaritura jane paraqitur ne Tabelen 6.

Sipas KPT-N.2-1989, forca prerese sizmike ne nje kat te dhene (k) eshte e barabarte me shumen e forcave sizmike qe veprojne ne katin qe studiojme e lart:

$$T_{(k)} = \sum_{k=k}^n E_{(k)}$$

Tabela 5. Masat e perqendruara ne nivelin e cdo kati.

Q5 (daN)	Q4(daN)	Q3(daN)	Q2(daN)	Q1(daN)
84288.75	158052.5	215750	282925	336412.5

Tabela 6. Forcat sizmike ne nivelin e cdo kati.

E ₅ (daN)	E4(daN)	E3(daN)	E2(daN)	E1(daN)
29525.58	44291.48	45345.16	39642.42	23568.45

Ne tabelen 7 jepen forcat sizmike Q dhe momentet M qe thith Zona 1 e murit sipas aksit 3.

Tabela 7. Forcat prerese dhe momentet qe thithet nga pjesa e konsideruar e murit.

Aksi i objektit	Pjesa e murit	Kati i objektit	Force sizmike E _i	Koeficienti shperndarjes μ	Forca ne mur Emur	Q daN/ml	$M = Q \frac{H}{2}$ (daN*m)
F	1	3	45345.16	0.24213	9598.615	9598.61524	1247819.981
F	1	2	39642.42	0.24213	12404.37	22002.98025	2860387.432
F	1	1	23568.45	0.24213	5706.626	27709.60594	3602248.772

Forca normale do te jete:

$$N_{12-12}=34335.84 \text{ daN}$$

Sipas KTP-N.2 1989, forca sizmike vertikale ne zonat me intensitet sizmik mbi VIII balle, merret sa 30% e ngarkeses perkatese statike vertikale.

$$N' = 1.3 * N_{12-12} = 1.3 * 34335.84 = 44636.59 \text{ daN} - \text{ per veprim nga lart-poshte.}$$

$$N'' = 0.7 * N_{12-12} = 0.7 * 34335.84 = 24035.08 \text{ daN} - \text{ per veprim nga poshte-lart.}$$

Kontrolli i seksionit ne prerje horizontale behet sipas relacionit te meposhtem:

$$Q \leq (R_{sq} + 0.8 * n * \mu * \sigma_0) * F$$

Ku:

R_{sq} - rezistenca llogaritese ne prerje sipas fugave te llacit.

n – koeficient qe merret = 1 per murature me tulla te plota.

μ – koeficienti i ferkimit ne fugat e muratures qe merret = 0.6.

F – seksioni llogarites i murit.

Forca sizmike nga lart-poshte do te jete:

$$Q' = (R_{sq} + 0.8 * n * \mu * \sigma_0') * F =$$

$$Q' = 44928.85 \text{ daN}$$

$$\text{Ku;} \quad \sigma_0' = \frac{N'}{F} =$$

Forca sizmike nga poshte-lart do te jete:

$$Q'' = (R_{sq} + 0.8 * n * \mu * \sigma_0'') * F =$$

$$Q'' = 27993 \text{ daN}$$

$$\text{Ku; } \sigma_0'' = \frac{N''}{F} =$$

Ne Zonen 1 te murit sipas aksit F, kontrolli i seksionit ne perkulje behet sipas relacionit te meposhtem:

$$Q \leq \frac{\sigma_0' * h * l^2}{H} \left(1 - \frac{\sigma_0'}{R}\right)$$

Ku:

R - rezistenca ne shtypje e muratures.

H – lartesia e katit.

Forca sizmike nga lart-poshte do te jete:

$$Q' = \frac{\sigma_0' * h * l^2}{H} \left(1 - \frac{\sigma_0'}{R}\right) :$$

$$Q' = 4149.85 \text{ daN}$$

Forca sizmike nga poshte-lart do te jete:

$$Q'' = \frac{\sigma_0'' * h * l^2}{H} \left(1 - \frac{\sigma_0''}{R}\right) =$$

$$Q'' = 15598.23 \text{ daN}$$

Ne Zonen 1 te murit sipas aksit F, kontrolli i seksionit ne prerje diagonale behet sipas relacionit te meposhtem:

$$Q \leq \frac{h * l * R_{tw}}{1.5} \sqrt{\frac{\sigma_0'}{R_{tw}} + 1}$$

Ku:

R_{tw} - rezistenca ne terheqje kryesore e muratures

Forca sizmike nga lart-poshte do te jete:

$$Q' = \frac{h * l * R_{tw}}{1.5} \sqrt{\frac{\sigma_0'}{R_{tw}} + 1} =$$

$$Q' = 14812.72 \text{ daN}$$



Forca sizmike nga poshte-lart do te jete:

$$Q'' = \frac{h * l * R_{tw}}{1.5} \sqrt{\frac{\sigma_0''}{R_{tw}} + 1} =$$


$$Q'' = 11202.88 \text{ daN}$$

Megense vlerat e aftesive mbajtese ne perkulje si per drejtimin lart-poshte ashtu edhe per drejtimin poshte-lart jane me te vogla se forcat prerese sizmike ne pjesen e konsideruar te murit , atehere mund te themi se ai nuk i perballon dot forcat sizmike, per pasoje ka pesuar edhe demtimet te cilat evidentohen ne Raportin e Vleresimit te Aftesise Mbajtese Struktureore.


Nderhyrjet per perforcimin e objektit




— "ERA



DETAJ I PERFORCIMIT TE MURIT SH 1:50



DETAJ I PERFORCIMIT TE MURIT SH 1:50



2. VLERESIMI I ELEMENTEVE TE TJERE KONSTUKTIVE TE OBJEKTIT.

Nje vleresim i shpejte i aftesise mbajtese eshte bere per edhe per elemente te tjere te objektit te konsideruar, sic jane soletat e cdo nderkati, shkallet si dhe brezat antisizmike. Vleresimi i tyre behet mbi bazen e kerkesave te kushtit sizmik KTP-N.2-89, si dhe mbi bazen e ngarkesave te shfrytezimit qe perputhen me destinacionin e ri te perdorimit te objektit. Ne baze te ketij vleresimi mund te nenvizojme sa me poshte:

1. Soletat e nderkateve jane parashikuar qe te mbajne nje ngarkese te perkohshme te normuar 300 daN/m^2 si dhe mure terthore 12cm. Ndersa, soletat monolite b/a jane parashikuar qe te mbajne nje ngarkese te perkohshme te normuar 300 daN/m^2 . Ne te dyja rastet, mund te themi se soletat perballojne ngarkesat e shfrytezimit.
2. Brezat antisizmike kane dimensione dhe armature gjatesore ne perputhje me kerkesat e kushtit sizmik KTP-N.2-89. Ato jane vendosur ne te gjitha katet, mbi te gjitha muret e objektit dhe ne te gjithe trashesine e tyre. Ne perputhje me kerkesat e kushtit sizmik KTP-N.2-89, breza antisizmike jane vendosur edhe ne nivelin e xokolatures se themelit.
3. Shkallet e ketij objekti jane projektuar dhe ndertuar prej betoni te armuar te derdhur ne vend. Nga inpektimi ne vend nuk rezultojne demtime ne konstruksionin e shkalleve.

3. VLERESIMI I SIGURISE SIZMIKE TE OBJEKTIT.

Kjo pjese e raportit fokusohet ne vleresimin e sigurise se ndertesese te permendur me siper nen veprimin e ngarkesave te termeteve. Rezultatet raportohen ne forme grafike ne Figuren 6. Ato konsistojne ne paraqitjen e nje Kurbe Fraxhiliteti (Building Vulnerability Curve) dhe nje Kurbe te Shkalles se Demtimit (Building Damage Ratio Curve).

Metodologjia e aplikuar eshte pershkruar shkurtimeisht me poshte:

Vulnerabiliteti i ndertesese eshte shprehur me ane te zhvillimit te kurbes se fraxhilitetit, e cila siguron propabilitetin e tejkalimit te nje niveli te pershkruar demtimi per nje diapazon te gjere intensitetesh te lekundjes se truallit. Kurba e fraxhilitetit eshte shume e rendesishme per vleresimin e pergjithshem te rezikut sizmik per strukturat ekzistuese nga termetet potenciale. Metodologjia per zhvillimin e ketyre kurbave ndjek nje procedure te thjeshte per te vleresuar demtimin sizmik te ndertesese. Per te realizuar llogaritjet perdoren tipi i ndertesese, kualiteti i projektimit, ndertimit dhe materialeve si edhe shpejtimi maksimal i truallit.

Selection	Building Type	
5	0	Wood
	1	Steel
	2	Reinforced concrete
	3	Reinforced concrete or steel with unreinforced masonry infill walls
	4	Reinforced masonry
	5	Unreinforced masonry (fired brick, concrete block and shaped stone)
	6	Adobe and adobe brick
	7	Stone rubble
	8	Lightweight shack (e.g. corrugated iron sheet) or lightweight traditional (e.g. bamboo)
	Rating Scheme	
Score	Quality of design	
1	0	Engineered with seismic design
	1	Engineered without seismic design, or non-engineered with seismic resistant rules of thumbs (e.g. lintel band for masonry)
	2	Non-engineered, no seismic resistant elements, good proportions (short, wide, symmetric)
	3	Non-engineered, no seismic resistant elements, poor proportions (tall, narrow, or non-symmetric)
Score	Quality of construction	
2	0	Excellent quality, effective supervision of seismic elements of construction
	1	Good quality, some supervision of seismic elements of construction
	2	Moderate quality, no supervision of seismic elements of construction but skilled workers
	3	Poor quality, no supervision and unskilled workers
Score	Quality of materials	
1	0	Good quality materials
	1	Poor quality materials, or poor maintenance of building
PGA	Input Earthquake Level	
0.26	0.0 - 1.4	Peak ground acceleration (G)

Thexsojme se kurba e fraxhilitetit na ndihmon per nje vleresim te shpejte te humbjeve te pergjithshme mbas veprimit te nje termeti te caktuar. Ne rastin tone ne kemi vleresuar termetin e priteshem mbi bazen e intesitetit te zones dhe kategorise se truallit, ne perputhje me kushtin sizmik KTP-N.2 1989. Objekti i shqyrtuar ndodhet ne nje zone me intensitet sizmik I = VIII balle sipas shkalles MSK-1964, dhe ndertohet mbi nje truall qe nga pikpamja sizmike vleresohet si i

kategorise se trete. Mbi keto te dhena, eshte vleresuar shpejtimi maksimal i truallit $a_g = 0.26g$. Mund te shihet edhe nga Figura 6 se ky shpejtim eshte perdorur per te vleresuar shkallen e demtimit te objektit.

Nga Figura 6 mund te permendim me radhe edhe faktoret e tjere qe jane mare ne llogaritje, si me poshte:

1. Ndertesa eshte seleksionuar si Tipi 5 – murature e paperforuar.
2. Kualiteti i projektit ka Vleresimin 1. Pra, objekti eshte konsideruar i projektuar me regulla inxhinierike por jo me nje rezistence te garantuar sizmike. Mendojme se tipi i zgjedhur per ndertesen dhe vleresimi i caktuar per projektin plotesojne njeri-tjetrin dhe si perfundim pasqyrojne realisht sjelljen e objektit te konsideruar ndaj termeteve.
3. Kualiteti i ndertimit ka Vleresimin 2. Pra, objekti eshte konsideruar si i ndertuar me nje cilesi te pranueshme, pa mbikqyrje inxhinierike te punimeve, por me punetori te kualifikuar.
4. Kualiteti i materialeve ka Vleresimin 1. Pra, materialet e perdorura per ndertimin e objektit jane materiale me cilesi jo shume te mire nga pikpamja e rezistences se tyre ndaj termeteve.





Figura 8. Kurba e Fraxhiliteti dhe Kurba e Shkalles se Demtimit.

Ne Figuren 8 jepen ne menyre grafike rezultatet e analizes se bere mbi bazen e te gjithë faktoreve te permendur me siper. Kurba e Fraxhilitetit tregon ne menyre propabilitare shkallen e demtimit te objektit ne funksion te shpejtimit te truallit. Ne Kurben e Shkalles se Demtimit pasqyrohet vleresimi ne perqindje i shkalles se pritshme te demtimit te objektit per vleren e pritshme te shpejtimit te truallit, qe ne rastin tone eshte 0.26g. Duket qarte nga Kurba e Shkalles se Demtimit se per shpejtimin e pritshem te truallit $ag = 0.26g$ ne objekt priten demtime mesatare deri ne te medha, por jo kolaps pjesor apo total i objektit.


4. PERFORCIMI I OBJEKTIT EKZISTUES

5.1 Perforcimi i themeleve

Perforcimi i themeleve te objektit ekzistues me emertim: "RIKONSTRUKSION I SHKOLLES SE MESME TE PERGJITHSHME "HAXHI LATA" SUÇ, BASHKIA KLOS", eshte realizuar me trare perforcues me permasa 40x40 cm te armuar me 4Φ16 lart dhe poshte dhe stafe Φ8/20 cm. Perforcimi eshte realizuar ne anen e jashtme dhe te brendshme te themeleve.



PRERJE I-I SH 1:20



PRERJE 2-2 SH 1:20




Figura 9. Perforcimi i Themeleve

5.1.1 Kontrolli i themeleve pas perforcimit te themeleve dhe mureve te objektit

Kontrolli i sforcimeve ne tabanin e themelit, ku shkarkon muri, behet per ngarkesat qe shkarkojne ne kuoten e sipërme te themelit, pra per ngarkesat e seksionit te fundit (20-20) pas peforcimit te mureve. Sforcimet qe rezultojne ne taban nga veprimi i kesaj ngarkese krahasohet me vleren e sforcimeve te lejuara te bazamentit qe jepet ne projektin ekzistues, $[\sigma] = 2.5 \text{ kg/cm}^2$. Pesha volumore e tokes e permendur ne Raportin e Vleresimit eshte $\gamma = 1.94 \text{ gr/cm}^3$.

$$N_{12-12} = 34335.85 \text{ daN}$$

Pesha vetiake e themelit, sipas permasave te referuara ne projektin ekzistues eshte:

$$N_{th} = \{(2 * 1.4)\} + (0.2 * 1.4) * g_{th} * l_c = 24584.56 \text{ daN}$$

Ngarkesa totale qe vjen ne tabanin e themelit:

$$N_t = N_{12-12} + N_{th} = 34335.85 + 24584.56 = 58.92 \text{ kN}$$

Sipas projektit te perforcimit, gjeresia e themelit te perforcuar ne kete seksion te konsideruar eshte, $b_{th} = 1.4 \text{ m}$. Sforcimet ne taban do te jene:

$$\sigma = \frac{N_T + l_c * h_{th} * \gamma}{l_c * b} =$$

$$\sigma = 2.41 \text{ daN/cm}^2$$

Duket qarte se ne seksionin e konsideruar aftesia mbajtese e lejuar e tokes eshte me e madhe se sforcimi i shkaktuar ne taban ($[\sigma] > \sigma$) nga veprimi i forcave te jashtme qe shkarkojne ne kuoten e sipërme te themelit. Mund te themi se themeli ne kete pjese te ndertesës është i garantuar, pra themeli i perforcuar eshte dimensionuar sakte.

5.1 Perforcimi i mureve

Perforcimi i mureve mbajtes te objektit ekzistues me emertim "RIKONSTRUKSION I SHKOLLES SE MESME TE PERGJITHSHME "HAXHI LATA" SUÇ, BASHKIA KLOS", eshte realizuar me shtrese perforcuese llac cemento 3 cm (jasht) dhe 35 cm (Brenda) te armuar me fi 4/15 cm (shih Projektin e Perforcimit). Perforcimi i mureve eshte kryer ne te gjithe lartesine e objektit.

5. KONKLUZIONE

Vleresimi nga ngarkimi statik dhe sizmik i objektit ekzistues me emertim: **"RIKONSTRUKSION I SHKOLLES SE MESME TE PERGJITHSHME "HAXHI LATA" SUÇ, BASHKIA KLOS"**, kontrolluar per gjendjen e tij ekzistuese perpara termetit te 26 Nentorit ne Durres, por duke konsideruar edhe demtimet e verejtura nga veprimi sizmik. Nga rezultatet e treguara te llogaritjeve dhe diskutimi i tyre rast pas rasti kane rrjedhur edhe konkluzionet e meposhtme per objektin e permendur me siper:

1. Nga kontrolli statik ka rezultuar se themelet nuk kane permasa te mjaftueshme per te perballuar ngarkesat qe shkarkojne ne to. Konkluzioni eshte bazuar ne krahasimin e sforcime qe transmetohen ne taban me vleren e lejuar te sforcimeve te tabanit te dhene ne projektin ekzistues si dhe ne studimin gjeologjiko inxhinierik te kryer nga Nord Construction Materials Laboratory.
2. Nga kontrolli statik i objektit ne gjendjen ekzistuese ka rezultuar se konstruksioni mbajtes prej murature ka aftesi mbajttese te mjaftueshme per te perballuar ngarkesat e perhershme dhe ato te shfrytezimit.
3. Nga kontrolli i veprimit sizmik ka rezultuar se konstruksioni mbajtes prej murature nuk eshte ne gjendje te perballoje ngarkesat sizmike qe shkarkojne ne murature ne disa prej akseve te objektit. Kjo do te thote se veprimet sizmike do te shoqeroheshin me demtime te objektit nese shpejtimi i trullit do te arrinte vleren e pritshme te projektimit $ag = 0.26g$. Nuk pritet qe nen veprimin e ketij termeti projektimi objekti te kaloje ne gjendje kolapsi. Megjithate, shkalla e pritshme e demtimeve eshte e larte. Demtimet e verejtura gjate termetit te 26 Nentorit ne Durres e konfirmojne konkluzionin e mesiper.
4. Per shfrytezimin e objektit me te njejtin destinacion kerkohet qe te behet riforcimi i tij. Ne momentin qe merret vendimi duhet te konsultohet patjeter me koston e punimeve qe duhen per te realizuar kete riforcim.
5. Bazuar ne llogaritjet e kryerja per kontrollin sizmik rekomandojme perforcimine themeleve te objektit me trare perforcues me permasa 40x40 cm ne anen e brendshme dhe te jashtme te themelit ekzistues dhe perforcimin e mureve mbajtes me shtrese perforcuese llac cemento 5 cm (jasht) dhe 5 cm (Brenda) te armuar me fi 4/10 cm (shih Projektin e Perforcimit).

RAPORTI U PERGATIT NGA

STAFI "ERALD-G"

Ing. Gezim ISLAMI